

Në përputhje me nenin 39 paragrafi 3 të ligjit “Për armët” (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 7/2005, 47/2006 dhe 42/2007), Ministri i Punëve të Brendshme miratoi

RREGULLOREN PËR DORËZIMIN, MARRJEN NË DORËZIM DHE MAGAZINIMIN E ARMËVE DHE MUNICIONEVE NË RAST VDEKJEJE TË ZOTËRUESIT TË ARMËS, SI DHE FORMËN DHE PËRMBAJTJET E DOKUMENTEVE TË MARRJES NË DORËZIM PËR ARMËN DHE MUNICIONIN E DORËZUAR PRANË AUTORITETEVE KOMPETENTE

Neni 1

Kjo Rregullore rregullon dorëzimin, marrjen në dorëzim dhe magazinimin e armëve dhe municioneve në rast vdekjeje të zotëruesit të armës, si dhe formën dhe përmbajtjen e dokumenteve të marrjes në dorëzim për armën dhe municionin e dorëzuar pranë autoriteteve kompetente.

Neni 2

Armët e kategorisë B,C dhe D në zotërim të një personi fizik i cili është ndarë nga jeta, do të çohen në stacionin më të afërt të policisë (në vijim referuar si: stacioni i policisë) nga anëtarët e familjes së zotëruesit të armës që është ndarë nga jeta që janë në moshë madhore ose nga persona të tjerë në moshë madhore që kanë jetuar në të njëjtën banesë me zotëruesin e armës.

Neni 3

Kur arma e përmendur në nenin 2 të kësaj Rregulloreje dorëzohet, oficeri i policisë verifikon identitetin e personit që solli armën, për të përcaktuar lidhjen e tij/e saj me zotëruesin e armës që nuk jeton më dhe kontrollon nëse arma është në zotërim të një personi tjetër fizik.

Pasi përfundon veprimet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, oficeri i policisë inspekton armën e dorëzuar dhe kopjet origjinale të dokumenteve që lidhen me armën. Pas inspektimit të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, oficeri i policisë plotëson një dokument të marrjes në dorëzim duke hedhur të dhëna rreth:

- anëtarit në moshë madhore të familjes së zotëruesit të armës që nuk jeton më ose të një personi tjetër në moshë madhore që ka jetuar në të njëjtën banesë me zotëruesin e armës dhe që dorëzon armën në stacionin e policisë;
- armës (lloji, marka, kategoria, numri i fabrikimit, sasia, kalibri dhe karakteristika të tjera të armës);
- zotëruesit të armës;
- dokumenteve që shoqërojnë armën; dhe
- oficerit të policisë që mori armën.

Pasi plotëson dokumentin e marrjes në dorëzim sipas paragrafit 2 të këtij neni, oficeri i policisë i lëshon dokumentin në fjalë anëtarit në moshë madhore të familjes së zotëruesit të armës që nuk jeton më ose një personi tjetër në moshë madhore që ka jetuar në të njëjtën banesë me zotëruesin e armës. Dokumenti i marrjes në dorëzim i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni do të lëshohet në fletë të bardhë me përmasa 21 cm x 30 cm dhe do të jetë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 4

Oficeri i policisë, pasi merr armën, regjistron në regjistrin e armëve dhe municioneve të konfiskuara, të gjetura dhe të dorëzuara informacionin e mëposhtëm: emrin, mbiemrin, vendbanimin dhe numrin unik të regjistrimit të qytetarit që dorëzoi armën, d.m.th të atij që e gjeti armën; kategorinë, llojin, markën, kalibrin dhe numrin e fabrikimit të armës; datën dhe vendin e dorëzimit, d.m.th kur u gjet arma; gjendjen aktuale të armës dhe të dhëna të tjera që janë të rëndësishme për ndryshimin e të dhënave të mëparshme të shënuara në regjistër.

Neni 5

Dispozitat e neneve 2, 3 dhe 4 të kësaj Rregulloreje do të zbatohen përkatësisht për armën e gjetur të kategorisë B,C dhe D.

Një armë e gjetur e kategorisë A do të raportohet menjëherë te një stacion policie nga personi fizik që e ka gjetur atë.

Dispozitat e neneve 3 dhe 4 të kësaj Rregulloreje do të zbatohen përkatësisht kur të merren në dorëzim dhe të trajtohen armët e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 6

Pas marrjes në dorëzim të armës, oficeri i policisë e dërgon atë menjëherë në magazinën e Sektorit të Punëve të Brendshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Pasi bëhet dërgimi i armës në magazinën e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, ajo mbahet në një dhomë të siguar në mënyrë të përshtatshme (në vijim referuar si: dhoma).

Arma do të ruhet në dhomën e përmendur në paragrafin 2 të këtij neni në raftë ose në kontejnerë metalikë në mënyrë të atillë që të garantohet akses i lehtë në vendin e mbajtjes së armës.

Arma do të ruhet e ndarë nga municionet, me përjashtim të armëve dhe municioneve që vendosen në kontejnerë të veçantë metalikë ose druri.

Neni 7

Dera e dhomës duhet të jetë prej metali të armuar ose druri të fortë, me një pllakë metalike në pjesën e jashtme me brava të armuara dhe e siguar më tej me anë të një brave sigurie dhe një shul.

Dera e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni duhet të hapet nga jashtë.

Neni 8

Dritaret e dhomës duhet të jenë prej metali të armuar ose druri të fortë, me një pllakë metalike në pjesën e jashtme me brava të armuara.

Numri i dritareve i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni duhet të mbahet në nivel minimal.

Në pjesën e jashtme, dritaret e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni duhet të mbrohen me një rrjetë teli, hapjet e së cilës nuk duhet t'i kalojnë dy centimetra.

Neni 9

Temperatura e dhomës duhet të variojë nga -10°C deri në 25°C. Lagështia përkatëse në dhomë nuk duhet të jetë më shumë se 75 përqind.

Neni 10

Oficeri i policisë përgjegjës për çelësin e dhomës kontrollon armën e marrë në ruajtje të paktën një herë në ditë gjatë kohës që arma ruhet në dhomë.

Nëse gjatë kontrolleve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni konstatohet se arma e marrë në ruajtje është zhdukur, oficeri i policisë përgatit menjëherë një raport që përfshin informacionin e mëposhtëm:

- emrin e Sektorit të Punëve të Brendshme ku ruhet arma;
- armën e zhdukur (lloji, numri i fabrikimit, kalibri dhe karakteristika të tjera të armës);
- datën, kohën dhe rrethanat në të cilat arma është zhdukur;
- masat e marra për përcaktimin e përgjegjësive lidhur me zhdukjen e armës; dhe
- fakte të tjera të lidhura me incidentin.

Raporti i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni do t'i përcillet Shefit të Sektorit të Punëve të Brendshme ku mbahet arma.

Neni 11

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e tetë pas botimit të saj në "Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
Sektori i Punëve të Brendshme _____

Nr. _____

Në zbatim të nenit 39 paragrafi 1 të ligjit “Për armët” (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 7/2005, 47/2006 dhe 42/2007) dhe nenit 3 paragrafi 3 të Rregullores për dorëzimin, marrjen në dorëzim dhe magazinimin e armëve dhe municioneve në rast vdekjeje të zotëruesit të armës, si dhe për formën dhe përmbajtjet e dokumentit të marrjes në dorëzim për armën dhe municionin e dorëzuar pranë autoriteteve kompetente (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. _/2007) lëshojmë këtë

DOKUMENT TË MARRJES NË DORËZIM

Më (data) _____ në ambientet e _____
personi _____ i lindur më
_____ në _____, me vendbanim në d.m.th
me qëndrim në _____ identiteti i të cilit përcaktohet bazuar
në nr. e kartës së identiteti/pasaportës _____ lëshuar nga
_____, i afërm me zotëruesin e armës që nuk jeton më
_____ dorëzoi armën dhe municionin e mëposhtëm.

Nr.	Lloji	Marka	Kategoria	Kalibri	Nr. i fabrikimit	Sasia	Vërejtje

Arma dhe municioni i dorëzuar renditen sipas nr. _____ dhe janë dorëzuar në gjendje të _____.

Armët dhe municioni i dorëzuar janë në zotërim të _____, lindur më _____ në _____, me vendbanim në d.m.th me banim _____ i cili u nda nga jeta më, _____ mbështetur nga një certifikatë vdekjeje _____. Për armën e dorëzuar personi që nuk jeton më kishte një dokument _____ të lëshuar nga _____

Arma e dorëzuar u gjet në _____

Arma e dorëzuar është marrë nga oficeri i policisë _____ me detyrë _____ në _____

Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 51, datë 24.4.2007

Arma dhe municioni i dorëzuar do të mbahen për tri ditë në stacionin e policisë _____, dhe pas kësaj do të mbahen në magazinën e Sektorit të Punëve të Brendshme deri në finalizimin e vlefshmërisë së procedurave, d.m.th deri në fund të një periudhe tremujore për gjetjen e zotëruesit të armës dhe të municionit.

Dokumenti i marrjes në dorëzim hartohet në gjashtë kopje, dy prej të cilave mbahen nga personi fizik që dorëzoi armën dhe municionin.

_____ vula _____
NËNSHKRIMI I PERSONIT QË DORËZOI ARMËN NËNSHKRIMI I OFICERIT TË POLICISË